

**Monitorimi i te licensuarve
nepermjet listes se llogarive
Statusi aktual i listes se llogarive
dhe masa e monitorimit qe
kryen ERE.**

Lavdie Konjari

Kuadri Ligjor

- Nenet 21, 23 te Ligjit nr 9072, date 23.05.2003 “per Sektorin e Energjise Elektrike” i ndryshuar:

ERE harton dhe miraton nje sistem te njejte dhe te standartizuar te llogarive per te licensuarit ne sektorin e energjise elektrike, mbeshtetur ne legjislacionin shqiptar dhe standartet e pranuar nderkombetare te kontabilitetit

Ne procesin e percaktimit te tarifave ERE:

- Eshte e nevojshme te njohe situaten financiare dhe ekonomike te pjesmarresve te licensuar te sektorit ne lidhje me fitimin/humbjen, dhe me ndryshimet e ndodhura per sa i takon aseteteve dhe detyrimeve.
- Te identifikojte lidhjet shkakesore midis tyre.

Pasqyrat financiare i lejonin ERE-s te krijonte nje perfytyrim te qarte ne drejtim te:

- Te ardhurave dhe shpenzimeve,
- Asetet e perftuara, asetet jomateriale
- Fluksin e parase
- Riparimet kapitale dhe korrente te kryera
- Informacion mbi borxhet dhe kredite

Megjithate:

- Ne drejtim te aseteve te kompanive nuk kishte mbajtje te qarta llogarish per sa i perket aktiviteteve te perdorimit te ketyre aseteve (KESH: gjenerim, shperndarje, furnizim te pandara; Privatet: per aktivitete te licensuara dhe te palicensuara)

Per kete arsye lindi nevoja e nje sistemi te ri llogarish

- Permiresimi i sistemit te deritanishem te mbajtjes se llogarive
- Plotesimi i tij me llogari dhe nenllogari ne lidhje me aktivitetet e rregulluara dhe te parregulluara.
- Sistemi i kontabilitetit i specifikuar ne Sistemin Uniform te Llogarive do te jete i zbatueshem per te gjitha Shoqerite e licensuara te sektorit te energjise elektrike, te cilat jane te detyruara te plotesojne kerkesat rregullatore per mbajtjen e llogarive ne perputhje me Ligjin Per Sektorin e Energjise Elektrike.

Sistemi i ri lejon te dallohet:

- Nje aktivitet i vecante i licensuar sipas divizioneve dhe karakteristikave funksionale.
- Kur nje kompani kryen me shume se nje aktivitet te licensuar – tipet e vecanta te aktiviteteve te licensuara.

Objektivat e Sistemit Uniform te Llogarive

- **Objektivi paresor** - te garantoje qe Sistemet e Kontabilitetit te kompanive te rregulluara te mund te gjenerojne lehtesisht te dhenat e percaktuara ne kerkesat e raportimit sipas legjislacionit ne fuqi.
- **Objektiva dytesore:**
- Te jete i pershtatur me Sistemin Kombetar Kontabel dhe Ligjin per Kontabilitetin si dhe te permbushi kerkesat e raportimit sipas IAS dhe IFRS-ve
- Te mbeshtesi kerkesat e ndryshme per raportin e brendshem dhe te jashtem per perdorues te ndryshem te informacionit financiar
- Te siguroje nje platforme te tille qe te ndryshoje lehtesisht nese ndryshojne kerkesat
- Te integroje raportimin per buxhetimin, financat dhe rregullatorin
- Te siguroje fleksibilitet per ndryshimet e ardhshme administrative
- Te jene lehtesisht te perdorshme

Struktura e Sistemit Uniform te Llogarive

- Manuali i Kontabilitetit per qellime te rregullimit te kompanive te licensuara ne sektorin e energjise elektrike. (Instruksione per perdorimin e USoA dhe paraqitjen e raportit vjetor te performances).
- Lista rregullatore e llogarive per kompanine e gjenerimit
- Lista rregullatore e llogarive per kompanine e transmetimit
- Lista rregullatore e llogarive per kompanine e shperndarjes
- Lista rregullatore e llogarive per furnizuesin publik
- (Te detajuara ne menyre qe lejojne alokimin e kostos per qellime te caktimit te cmimit, benchmarkun dhe per te dhene sigurine ne lidhje me zbatimin e kushteve te licenses. Cdo llogari eshte e ndare per aktivitetet e rregulluara dhe te parregulluara)

Sistemi i numerimit te USoA

- Cdo llogari ka nenllogari treshifrore
- Ne disa raste numrat jane kaluar qe te lejojne zgjerim ose koordinim me te mire te sistemit te numerimit.
- Regjistrimet e llogarive do te lejojne analizat nepermjet llogarive te USoA dhe te lejojne pergatitjen e raporteve rregullatore direkt nga rregjistrimet e kompanive sipas llogarive te pershkruara ne USoA

Manuali

- Udhezime mbi periudhen kontabel, regjistrimet kontabel (dokumentacioni justifikues, afati i ruajtjes se librave kontabel etj)
- Perkufizimet, kategorite, struktura si dhe dhe metodat e vleresimit per aktivet ne pergjithesi.
- Inventaret, kerkesat e arketueshme
- Aktivet e mbajtura ne perdorim
- Shpenzimet e shtyra
- Aktivet e qendrueshme materiale (metodat e amortizimi dhe vleresit te jetegjatesise se tyre)
- Aktivet Afatgjata Jomateriale
- Llogarite e pambledheshme “Borxhi i keq”
- Kapitali i punes
- Detyrimet
- Shpenzimet operative

Aktivet e qendrueshme

Testi i asetit te perdorshem dhe te dobishem dhe Testi i Investimeve te kujdesshme

- **Testi i perdorimit** perdoret nga Rregullatori per tu siguruar qe asetete u perdoren realisht ne sherbim dhe ishin te dobishem ne dhenien e sherbimit. Ne te kundert ERE mund te vendose ti perjashtoje keto asetete nga RAB.
- **Testi i Investimeve te kujdesshme** perdoret per te percaktuar nese i licensuari ka treguar kujdes ne blerjen dhe ndertimin e aseteteve te vecanta, bazuar ne informacionin qe ka dhe rrethanat qe kane ekzistuar kur eshte marre vendimi. Nese asetete nuk e kalon testin e investimeve te kujdesshme, ERE mund te vendosi qe ta perjashtoje ate nga RAB

Vleresimi I Aseteve

1. Kosto historike
2. Vlera e tregut
3. Kosto e zevendesimit
 - Sipas USoA, kompanite zbatojne metoden e aprovuar nga ERE
 - Kosto historike pergjithesisht e pranueshme nga rregullatori
 - Kur perdoret Kosto e zevendesimit ose Vlera e tregut , ajo pjese mbi koston historike mund te jete subjekt amortizimit mbi nje baze kohore te ndryshme nga ajo e perdorur per koston historike.

Inventaret

- Metoda e identifikimit specific (kosto te vecanta per njesi te identifikuara te inventarit)
- Kosto mesatare e ponderuar (llogaritet periodikisht apo per cdo dergese)

Kerkesat per arketim (Borxhi i keq)

- Kerkesat per arketim raportohen me vleren e fatures nga e cila eshte zbritur nje provizion per renie vlere.
- Llogarite e pambledhshme trajtohen si shpenzime te shitjes me kredi. Shpenzimet per borxhin e keq raportohen per periudhen kontabile ne te cilen realizohet shitja.
- Metoda e Pasqyres se te Ardhurave (Perqindja e shitjeve)
- Metoda e Pasqyres se Bilancit (Perqindja mbi llogarite e arketueshme te jashtezakonshme)

Kapitali i Punes

- Perfaqeson investimin capital te kryera nga pronari gjate intervalit te kohes midis kryerjes se shpenzimit per sigurimin e sherbimit dhe vjeljes se te ardhurave nga klientet
- Shuma e lejuar e kapitalit te punes do te perbehet nga: para ne dore, minimumi i balances ne banke, dhe materiale e parapagesa dhe pagesat e taksave dhe do te jete e mjaftueshme per te mbuluar diferencen ne kohe te pageses se kosos se sherbimit dhe arketimit per ate sherbim.
- Shuma e lejuar per kapitalin e punes ne para eshte nje llogaritje e parase te siguruar nga investitori per te financuar Rezerven e paracaktuar per Kostot e Operimit te kompanise ne periudhen ne te cilen arketohen te ardhurat operative. Percaktuar nepermjet studimit “lead-lag”.

Kapitali i Punes (vazhdim)

- Percaktimi i kapitalit te punes te kerkuar pepermjet “Performances se studimit te drejtimit te vonesave(lead/lag study)”. Krahasohet diferenca ne kohen e kryerjes ose kohen e voneses midis hyrjeve dhe daljeve te parave. Diferenca kohore sipas metodes (lead and lag) shumezohet pastaj me shpenzimet operative mesatare ditore per te mberritur ne nivelin e kerkuar te kapitalit te punes qe do te perfshihet ne bazen rregullatore

Shpenzimet

- Struktura e listes se llogarive eshte detajuar per qellime rregullatore dhe lejon kur eshte e nevojshme qe te nxirren informacione plotesuese, pertej klasifikimit per raportim te perfshire ne Pasqyren e te ardhuravedhe shpenzimeve te kompanise per qellime te mekanizmit rregullues.
- Shpenzimet sipas natyres ekonomike duhet te raportohen ne llogarite ne Grupin 60 te shpenzimeve sipas natyres ekonomike, dhe shpenzimet Operative duhet te raportohen ne llogarite ne Grupin 61 te shpenzimeve Operative

Alokimi i kostove

- Kerkese e rendesishme eshte diferencimi i qarte dhe ndarja financiare e aktiviteteteve te rregulluara nga ato te parregulluara te cdo kompanie energjitike. USOA perfshin klasifikimin e kostove si vijon:
 1. Sipas funksioneve
 2. Sipas natyres
 3. Sipas grupeve te konsumatoreve
 4. Sipas nivelit te tensionit
- Metodologjia per alokimin e kostove te perbashketa sipas funksioneve ne perputhje me llogarite e shpenzimeve sipas funksioneve te pershkruara ne USOA, duhet te bazohet ne analiza inxhinerike, ekonomike dhe statistikore.
- Ne mungese te dhenave te detajuara i licensuari duhet te propozoje faktore alokimi per ndarjen e kostove midis dy ose me shume funksioneve dhe duhet te jete i gatshem ti justifikoje tek ERE.

Lidhja midis USoA dhe Tabelave te aplikimit per cmime

Retail Supply Services

Line No.	Col. 1	Col. 2	Col. 3	Col. 4	Col. 5
	Cost Description	Ref. nr in USoA	Allocation Factor	Rate Class 1 (Mln LEKE)	Rate Class 2 (Mln LEKE)
1	Purchased Power				
2	Transmission Service Expenses				
3	Distribution O & M Expenses				
4	Management				
5	Research Department				
6	Load Dispatching				
7	Station expenses				
8	Overhead lines				
9	Underground lines				
10	Line transformers				

Statusi aktual

- Vendimi i Bordit te Komisionereve Nr. 85 dt 26.12.07 "Per fillimin e procedurave per Sistemin Unik te Llogarive" shenoi fillimin e procesit te hartimit te USoA.
- Eksperienca e workshpeve per kete qellim nga USAID.
- Konsultime me perfaqesues te KESH sh.a. , OST dhe aktore te tjere ne sektorin energjistik.
- Drafti i USoA i eshte derguar paleve te interesuara per te paraqitur komentet dhe propozimet e tyre. Varianti perfundimtar do te marre parasysh edhe reagimet e tyre.

Monitorimi

- Jemi ne fazen e ngritjes ne ERE te strukturave te monitorimit;
 - Sektori i monitorimit te tregut
 - Sektori i monitorimit te te licensuarve.

Lista e Unifikuar e Llogarive - element i rendesishem per kryerjen e Reformave ne Sektorin Energjistik

- USoA redukton ne ne menyre te dukshme **Rrezikun rregullator** te veprimtarive te biznesit dhe investimeve duke u siguruar investuesve:
- **Konsekuence**-te gjithë kompanite do te trajtohen ne menyre te njejte gjate percaktimit te cmimit, monitorimit.
- **Drejtesi** - metode te drejte ne perrcaktimin e bazes per vendosjen e tarifave dhe monitorimin.
- **Transparence** – te gjithë elementet e cmimit do te njihen nga kompanite dhe klientet e tyre.

FALEMINDERIT